

DAC_BUP_01: Dërgimi i Kapaciteteve Ndërkufitare dhe Kufizimeve të Alokimit

Shënime:

Si parim i përgjithshëm, nëse kjo procedurë rezervë nuk mund ta zgjidhë problemin deri në 11:30 (Afati i fundit per Bashkimin e plotë te Tregjeve për çështjet që lidhen me CZC), operatorët referojnë në **DAC_FAL_01** – Menaxhimi i Incidencës.

Përbajtja

1.	Hyrje.....	3
1.1.	Qëllimi	3
1.2.	Qeverisur / Rregulluar nga	3
1.3.	Mjetet dhe Protokolli i Komunikimit	3
1.4.	Procedurat shoqëruese.....	3
2.	Procedura.....	4
2.1.	Pasqyrë e përgjithshme.....	4
2.2.	Rastet e rrezikut - Sqarimi i procesit	5
	Rasti 3: Sistemi Lokal -i Tregtimit NEMO nuk mund të marre CZC-të dhe Kufizimet e Alokimit.....	6
	Rasti 4: Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO refuzon CZC-të dhe Kufizimet e Alokimit.....	6
	Rasti 5: CZC-të dhe Kufizimet e Alokimit duhet të përditësohen pas Kohës së Synuar.....	6
	Rasti 6: Çështjet në lidhje me CZC-të për interkonektorët me dorëzim të dyanshëm.....	7
	Rasti 7: Refuzimi i Skedarit të të Dhënave të Rrjetit nga Sistemi TI i Ofryesit te Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve.....	7
3.	Faza e fundit e fillimit te procedures tjeter normale	8
4.	Hetimi dhe raportimi i Incidencës.....	8

1. Hyrje

Kapacitetet Ndërkufitare (CZC) dhe Kufizimet e Mundshme të Alokimit përcaktohen nga OST-të dhe i dorëzohen Sistemit Lokal të Tregtimit të NEMO-s. NEMO më pas ia përcjell këto të dhëna Sistemit TI të Ofruesit të Shërbimit të Bashkimit të Tregut (MC). Kjo procedurë rezervë përshkruan të gjitha rastet e rrezikut që lidhen me procedurën DAC_NOR_01.

1.1. Qëllimi

Si shënim i përgjithshëm, procedurat rezervë të DAC synojnë të ofrojnë një kornizë të përbashkët me të cilën duhet të përputhen të gjitha procedurat lokale.

Qëllimi i kësaj procedure është të ofrojë një përbledhje të zgjidhjeve rezervë të zbatueshme në rast të problemeve në fazën Para Bashkimit te Tregjeve, të cilat mund të rrezikojnë marrjen në kohë të CZC-ve dhe Kufizimet e Mundshme të Alokimit nga Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s.

Zgjidhjet rezervë të përmendura më poshtë mund të aplikohen vetëm përpara orës 11:30, që është Afati i fundit per Bashkimin e Plotë te Tregjeve për çështjet që lidhen me CZC-në.

Në rast se çështja vazhdon ende në orën 11:00, Afati i Fundit për të Filluar Komitetin e Incidencës (IC) për çështjet që kanë lidhje me CZC-në, do të fillojë punën IC-ja sipas procedurave DAC_FAL_01.

Nëse zgjidhjet rezervë nuk e zgjidhin problemin përpara orës 11:30 dhe CZC-të nuk janë ende të disponueshme, Komiteti i Incidencës do të deklarojë Ndarje e Plotë nga DAC.

Procedurat lokale përmenden vetëm për qëllime referimi, ndërsa zgjidhjet normale rezervë shpjegohen më në detaje.

1.2. Qeverisur / Rregulluar nga

- Marrëveshja Operacionale e Bashkimit të Tregut të Ditës në Avancë (DACOA)
- NEMO - Procedura e Ofruesit të Shërbimeve MC



1.3. Mjetet dhe Protokolli i Komunikimit

- Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s
- Sistemet e TI të OST-ve

1.4. Procedurat shoqëruese


Procedurat normale:

- DAC_NOR_01: Dorëzimi i Kapaciteteve Ndërkufitare dhe Kufizimeve të Alokimit sipas Procedurave Normale
- DAC_NOR_02: Rezultatet Perfundimtare të MC

Procedura të tjera të lidhura:

- DAC_FAL_01: Menaxhimi i Incidencës
- DAC_OTH_02: Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm
- DAC_FAL_02: Ndarja e Plotë e Bashkimit te Tregjeve

Grafiku i mëposhtëm tregon procesin CZC.



2. Procedura

2.1. Pasqyrë e përgjithshme

Tabela më poshtë jep një listë të gjitha rasteve të rrezikut që janë identifikuar në procedurën DAC_NOR_01 dhe tregon se cilat veprime duhet të ndërmerren në nivel DAC për të zgjidhur çështjet e identikuara.

Tabela 2 – Rastet e rrezikut të lidhura me procesin CZC

Rasti i rrezikut	Procesi	Koha e Synuar	Afati i fundit për të filluar punë IC-ja për çështje të lidhura me CZC-në	Afati i Ndarjes së Plotë te Bashkimit te Tregjeve për çështjet që lidhen me CZC-në	Mjetet	Zgjidhje rezervë	Procedura Rezerve
1	CZC-të dhe Kufizimet e Alokimit nuk janë gati në Kohën e Synuar për shkak të problemeve teknike/ të llogaritjes.	[REDACTED]	11:00	11:30	Sistemet e TI të OST-së	Procedurat rezervë të OST-së	DAC_FAL_01
2	Sistemet TI te OST-së nuk mund t'i dërgojnë CZC-të dhe Kufizimet e Alokimit përparrë Kohës së Synuar në Sistemin Lokal të Tregtimit të NEMO-s.	[REDACTED]	11:00	11:30	Sistemet e TI të OST-së	Dërgimi i skedarëve në menyren Backup	DAC_FAL_01
3	Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-së nuk mund të marrë CZC-të dhe Kufizimet e Alokimit.	[REDACTED]	11:00	11:30	Sistemi Lokal i Tregtimit i NEMO-s	Ngarkimi manual i skedarëve nga Sistemi Lokal i tregtimit të NEMO-së	DAC_FAL_01

4	Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s nuk pranon CZC-të dhe Kufizimet e Alokimit.	[REDACTED]	11:00	11:30	Sistemi Lokal i Tregtimit i NEMO-s	NEMO kontakton OST-në përkatëse	DAC_FAL_01
5	CZC-të dhe Kufizimet e Alokimit duhet të përditësohen pas Kohës së Synuar (të lejuar deri në orën 11:00).	[REDACTED]	[N/A]	11:30	Sistemet TI të OST-së	Operatori i OST-se përditëson dhe ridërgon skedarët tek NEMO.	DAC_FAL_01
6	Çështjet në lidhje me CZC-të përdorëzim të dyanshem të interkonektorëve.	[REDACTED]	11:00	11:30	-	Procedura lokale	DAC_FAL_01
7	Refuzimi i Skendarit të të Dhënavë të Rrjetit nga Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s	[REDACTED]	11:00	11:30	Sistemet TI të OST-së, Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO	Procedura lokale	DAC_FAL_01

2.2. Rastet e rrezikut - Sqarimi i procesit

Rasti 1: CZC-të dhe Kufizimet e Alokimit nuk janë gati në Kohën e Synuar për shkak të problemeve teknike/ të llogaritjes.

Në rast se CZC-të dhe Kufizimet e Alokimit nuk mund të krijohen për shkak të çështjeve teknike ose të llogaritjes në Kohen e Synuar, OST-ja përkatëse duhet të kontaktojë sa më shpejt të jetë e mundur me NEMO-n për ta informuar rreth çështjes. NEMO do të informojë Ofruesin e Shërbimit të MC-së për vonesën.

OST-ja përkatëse zbaton procedurat e veta rezervë për të zgjidhur problemin.

Nëse çështja vazhdon ende në orën 11:00 (Afati i Fundit për të filluar Komiteti i Incidencës për çështjet që kanë lidhje me CZC-në), do të fillojë punën IC-ja sipas procedurave DAC_FAL_01.

Mesazhet në lidhje me këtë do të dërgohen sipas procedures lokale.

Rasti 2: Sistemi TI i OST-së nuk mund t'i dërgojë CZC-të dhe Kufizimet e Alokimit përpara Kohës së Synuar në Sistemin Lokal të Tregtimit të NEMO-s.

Kur Sistemet TI të OST-të të kenë përcaktuar CZC-të dhe Kufizimet e Alokimit, këto duhet të dërgohen automatikisht si skedar nga OST-ja në Sistemin Lokal të Tregtimit të NEMO-s përpara Kohës së Synuar.

Nëse një ose më shumë nga Sistemet TI të OST-ve hasin probleme me dorëzimin, duhet të kryhen veprimet e mëposhtme:

- a) Operator i Sistemit TI të OST-së kontakton NEMO-n me telefon ose [REDACTED]
- b) Nëse NEMO nuk ka informacion nga OST-ja përkatëse, atëherë NEMO kontakton me telefon Operatorin e Sistemit TI të OST-së përkatëse dhe NEMO kontakton Ofruesin e Shërbimit të MC-së sipas marrëveshjes perkatëse.
- c) OST dërgon të dhënat në menyren rezerve sipas procedures lokale rezervë dhe NEMO i ngarkon të dhënat sipas procedures lokale.

Nëse veprimi i mësipërm nuk e zgjidh çështjen para Afatit të Fundit i Fillimit të Komitetit të Incidencës (11:00), Komiteti i Incidencës do të fillojë punën sipas procedures DAC_FAL_01.

Mesazhet në lidhje me këtë do të dërgohen sipas procedures lokale.

Rasti 3: Sistemi Lokal -i Tregtimit NEMO nuk mund të marre CZC-të dhe Kufizimet e Alokimit

Pasi sistemet TI të OST-së të kenë përcaktuar CZC-të dhe Kufizimet e Alokimit, këto duhet të dërgohen automatikisht nga Sistemi TI i OST-ve në Sistemin Lokal të Tregtimit të NEMO-s në Kohën e Synuar.

Nëse Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s nuk i merr të dhënat në Kohen e Synuar, duhet të kryhen veprimet e mëposhtme:

- a) NEMO kontakton me telefon Operatorin e OST-së përkatëse dhe NEMO informon Ofruesin e Shërbimit MC-së sipas procedurës përkatëse.
- b) Nëse Operatori i OST-së përkatëse nuk ka informacion nga NEMO dhe Operatori i OST-së nuk ka marrë një konfirmim nga Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO, ai kontakton NEMO-n me telefon;
- c) NEMO merr skedarët në mënyrën rezerve nga Sistemi TI i OST-ve dhe i ngarkon ato sipas procedurës lokale rezervë;

Nëse veprimi i mësipërm nuk e zgjidh çështjen deri në 11:00 (Afati i Fundit të Fillimit të punës së Komitetit të Incidences për arsyen e CZC-së) Komiteti i Incidencës do të fillojë punën sipas procedures DAC_FAL_01.

Rasti 4: Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO refuzon CZC-të dhe Kufizimet e Alokimit

Kur Sistemet TI të OST-ve kanë përcaktuar CZC-të dhe Kufizimet e Alokimit, këto duhet të dërgohen automatikisht nga Sistemet TI të OST-ve në Sistemin Lokal të Tregtimit të NEMO-s në Kohën e Synuar.

Nëse Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s refuzon CZC-të dhe/ose Kufizimet e Alokimit për shkak se skedari nuk është i plotë ose se nuk kalon kontrollin sintaksor, duhet të kryhen veprimet e mëposhtme:

- a) NEMO duhet të kontaktojë Operatorin e OST-së përkatëse me telefon/email dhe të informojë Ofruesin e Shërbimit të MC-së për arsyen e refuzimit;
- b) Shpjegon arsyen e refuzimit dhe kërkon një version të ri të skedarit;
- c) Operatori i OST-së perkatese e dërgon skedarin edhe një herë sipas procedurës lokale.

Nëse veprimi i mësipërm e zgjidh problemin dhe skedari i ri pranohet, ndiqen procedurat normale si zakonisht. Nëse skedari i ri nuk pranohet, hapat e mësipërm riprovohen për të zgjidhur problemin.

Nëse veprimi i mësipërm nuk e zgjidh çështjen deri në 11:00 (Afati i Fundit të Fillimit të Komitetit të Incidencës për arsyen e CZC-së) Komiteti i Incidencës do të fillojë punën sipas procedures DAC_FAL_01.

Mesazhet në lidhje me këtë do të dërgohen sipas procedures lokale.

Rasti 5: CZC-të dhe Kufizimet e Alokimit duhet të përditësohen pas Kohës së Synuar

CZC-të dhe Kufizimet e Alokimit mund të përditësohen në situata normale përpara Kohës së Synuar.

Përveç kësaj, OST-të mund të kërkojnë një përditësim të CZC-ve dhe Kufizimeve të Alokimit ndërmjet orës [] dhe 11:00. Pas orës 11:00 (afati i fundit i vendosur i Ditës në Avancë), CZC-të dhe Kufizimet e Alokimit nuk mund të përditësohen më.

Për shkak të faktit se Anëtarët e Bursës do të kishin ende edhe 60 minuta për të reaguar ndaj CZC-ve të përditësuara dhe Kufizimeve të Alokimit, Koha e Mbylljes se librit te urdhërporosive te NEMO-s nuk do të vonohej me për shkak të përditësimeve të CZC-ve dhe Kufizimeve të Alokimit.

Nëse një OST ka nevojë dhe lejohet nga rregullat lokale të përditësojë CZC-të dhe/ose Kufizimet e Alokimit pas Kohes së Synuar, por para orës 11:00 duhet të kryhen veprimet e mëposhtme:

- a) OST-të informojnë NEMO-n me telefon/email se një e dhënë e re me një CZC të përditësuar dhe/ose Kufizime të Alokimit do të mbërrijet pas Kohës se Synuar, por para orës 11:00.
- b) NEMO informon Ofruesin e Shërbimit të MC-së sipas procedures perkatese.
- c) OST-të i dërgojnë vlerat e përditësuara tek NEMO përpara orës 11:00 sipas procedures lokale.
- d) NEMO merr skedarin dhe ia dërgon Sistemit TI te Ofruesit të Shërbimit të MC-së, sipas procedures perkatese.

Nëse përditësimi i CZC-ve në Sistemin e Tregtimit NEMO nuk realizohet ndërmjet orës 11:00 dhe 11:30, atëherë ka 3 mundesi zgjidhje:

1. Përdoren CZC-të e mëparshme;
2. CZC-të vendosen në zero (interkonektori në fjalë është *de facto* i ndare);
3. Nuk ka alokim kapaciteti në linjë.

NEMO dhe OST-ja do të ndjekin opsjonin(et) e rëna dakord në proceduren lokale. NEMO mund të informojë Anetaret e Burses nëpërmjet një komunikimi të jashtëm, sipas procedures lokale, në mënyrë që ti informojë ata në lidhje me përditësimin.

Rasti 6: Çështjet në lidhje me CZC-të për interkonektorët me dorëzim të dyanshëm.

Rreziku kryesor që lidhet me procesin CZC për interkonektorët me dorëzim të dyanshëm është mospërputhja e CZC-së e zbuluar nga kontrolli i Sistemit Lokal të Tregtimit të NEMO-s. Duhet patur parasysh se burimi i vlerave CZC është i ndryshëm (pasi vjen nga OST-të kunderpale).

Zgjidhjet për çështjet që lidhen me CZC-të për interkonektorët me dorëzim të dyanshëm pëershkuhen në Proceduren Lokale. Ato përmenden këtu vetëm për të siguruar lidhjen me procedurat përkatëse.

Rasti 7: Refuzimi i Skedarit të Dhënavës të Rrjetit nga Sistemi TI i Ofruesit te Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve

NEMO prodhon një skedar të Dhënavës të Rrjetit bazuar në vlerat CZC të marra nga Sistemet TI i OST-ve.

Sapo kedari i të Dhënavës të Rrjetit t'i dërgohet Ofruesit të Shërbimit të MC-së, Ofruesi i Shërbimit të MC-së do të kontrollojë nëse skedari i kalon validimet e aplikueshme.

Nëse validimet e aplikueshme nuk janë të suksesshme, Sistemi TI i Ofruesit te Shërbimit të MC-së do të refuzojë skedarin e të Dhënave të Rrjetit dhe NEMO do të marrë një ACK negative.

Nëse Skedari i të Dhënave të Rrjetit refuzohet nga Sistemi TI i Ofruesit te Shërbimit të MC-se, Sistemet TI te OST-ve do të duhet të korrigojnë skedarin CZC dhe do t'i ofrojnë një version të ri NEMO-s, nëpërmjet mënyrës së rregullt të komunikimit.

Nëse Sistemit TI te Ofruesit të Shërbimit të MC-së nuk mund t'i ofrohet akoma një Skedar i vlefshëm i të Dhënave të Rrjetit deri në orën 11:00 (afati i fundit për të filluar një IC për arsyet CZC), do të nise një IC sipas procedurës DAC_FAL_01.

Nëse Sistemit TI te Ofruesit të Shërbimit te MC-së nuk mund ti afrohet akoma një skedar i vlefshëm i të Dhënave të Rrjetit deri në orën 11:15, NEMO do të informojë palët e tjera dhe Anëtarët e Bursës për rrezikun e Ndardjes së Plotë te Bashkimit te Tregjeve nga DAC.

Ky informacion do të jepet duke dërguar mesazhin e jashtëm të përshkruar në procedurën DAC_OTH_02.

Nëse Sistemit TI te Ofruesit të Shërbimit të MC-së nuk mund t'i ofrohet akoma një Skedar i vlefshëm i të Dhënave të Rrjetit deri në orën 11:30, referojuni procedurës DAC_FAL_02.

3. Faza e fundit e fillimit te procedures tjeter normale

Faza e fundit për të filluar procesin tjeterë është kur Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s të ketë marrë me sukses CZC-të dhe Kufizimet e Alokimit.

4. Hetimi dhe raportimi i Incidencës

Kur përfundon procesi i bashkimit të çmimeve në rast se është organizuar një Komitet i Incidencës, NEMO është përgjegjës për plotësimin e Raportit të Komitetit të Incidencës dhe të shpërndajë te të gjitha palët e Komitetit të Incidencës, siç përshkruhet në proceduren DAC_FAL_01.